



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më  
Dana 04-09-2017

PKR.nr.133/16



NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
 gjykatë e shkallës së parë penale, me kryetarin e trupit gjykues Musa Konxheli me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale ndaj te pandehurit [REDACTED], nga [REDACTED] rruga "I [REDACTED]" nr. [REDACTED], për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr.62/16 te dt. 4 Gusht 2016, në praninë e Prokurorit të shtetit Shukri Jashari, të pandehurit [REDACTED], mbrojtësit të tij me autorizim av. [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më dt.06.09.2016. sjell dhe publikisht shpalli këtë :

**AKT GJYKIM**

**I pandehuri:** [REDACTED], i biri i [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], i lindur me datë [REDACTED] me vendbanim në [REDACTED], rr. [REDACTED] i, numër [REDACTED], pa pseudonim, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i firmës "[REDACTED]" që merret me prodhimin e parketit dhe kuzhinave, i martuar, prind i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, në paraburgim prej dt.06.06.2016

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me dt.25 maj 2016, rreth ores 10.00 në firmën transportuese "[REDACTED]" e cila gjendet në magjistralen [REDACTED], në [REDACTED] pa autorizim ka dorëzuar për transport substanceën e dyshuar të llojit marihuana, në peshë 58 kg, në atë mënyrë që pasi i pandehuri nga personat e panjohur ka siguruar substance e dyshuar narkotike të llojit maruan, të paketuar në qese të najlonit, I njejtë paraprakisht ka siguruar taksistin [REDACTED], me të cilin kanë arritur marrëveshje që për 80 euro, ti transporton disa mobilie-

kauçë për në firmën transportuese "██████████" në ██████████, e cila firmë e cila merret me transportimin e mallrave mbrenda dhe jashtë territorit të Kosovës, e që pas dy ditëve mobilitet të dërgohen në shtetin e ██████████, taksisti së bashku me të pandehurin kanë ngarkuar mobilitet në kamionin furgon me targë të regjistrimit ██████████, të firmës "██████████" pastaj të njejtën dërgesë e ka dorëzuar në firmën transportuese sipas ushëzimeve të pandehurit, pas kontrollimit të policies njësitit antidrogë janë gjetur 58 kg. me substancë të dyshuar narkotike të llojit mariuhan nga të mbështjellura në qese të najlonit, të cilat kanë qenë të vendosura në brendinë e kauçit, me çrast substanca e dyshuar narkotike është sekuestruar përkohsishtë nga policia,

me të cilën kreu veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenëve 3, 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 52, 73, 75, 76 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-se dhe nenit 359 e 365 të KPRK-se

## I. AKTGJYKIM FAJESUES

### G J Y K O N

Te akuzuarin ██████████,

Per veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së,

- **ME DËNIM BURGIMI:** në kohëzgjatje prej 3(tre) vite në të cilin llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.06.2016 deri me dt. 07.09.2016 Koha e mbetur e dënimit me burg do të ekzekutohet pas plotëfuqishmerise se këtij aktgjykimi;

- Me dënim me gjobë në shumë prej 4000 ( katër mijë) euro të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë.

Ne rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 46 par 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobe do ti shndërrohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do ti llogaritet një ditë burgu.

Me kërkesën e të pandehurit dënimi me gjobë mund të paguhet edhe me këste mujore dhe atë deri më 5 këste mujore dhe ate ne afat jo me larg se 6 muaj nga plotëfuqishmeria e ketij aktgjykimi.

Konform nenit 273 par.5 të KPRK-së, konfiskohen në mënyre te përhereshme: sendet e sekuestruara përkohësishtë dhe substanca narkotike e llojit marihuana me peshe 58 kg, të sekuestruar përkohësisht nga Policia e Kosoves.

URDHEROHET Policia e Kosoves qe pas plotëfuqishmërise së ketij aktgjykimi ta bëj; shkatërrimin e substancave narkotike të llojit marihuana me peshe 58 kg të konfiskuara në mënyrë te përhereshlune

I akuzuari [REDAKTUAR] obligohet që në emër te shpenzimeve ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30/tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së ketij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### Historiku i procedures

Prokuroria e Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PPA.nr.62/16 te dt.4 gusht 2016, me te cilen e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], rruga" [REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR], per shkak te veprës penale" blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së



Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar gjyqësor më dt. 06.09.2016 në të cilin prokurori i shtetit Shukri Jashari në tërësi ka mbetur pranë akuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtor për veprën penale si që janë përshkruar në dispozitivin e aktakauzes dhe t'ju shqiptohet dënimi sipas ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar gjyqësor e ka pranuar fajsinë me të cilën e ka ngarkuar akuza duke premtuar se në të ardhmen asnjëherë nuk do të kryej vepra penale tjera apo të ngjashme.

Meqenëse i pandehuri [REDAKTUAR] ka pranuar fajsinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakauza në të gjitha pikat e sajë, i cili pranim është në përputhje me kriteret e përcaktuara me neni 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues pasi paraprakisht ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shtetit, dhe mbrojtësit të të pandehurit avok. [REDAKTUAR], konform neni 248 par.5 të KPPK-së ka pranuar fajësinë e të pandehurit në shqyrtimin fillestar.

#### **Analiza e ligjit material**

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se ekzistojnë elementet e veprës penale në veprimet e të pandehurit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], rruga "I [REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së

Kryerja e veprave penale nga të akuzuarit vertetohet edhe nga provat tjera të propozuara nga prokurori i shtetit në aktakuzën e cila është objekt shqyrtimi dhe atë: Vertetimi mbi sekuestrimin e perkoheshëm të sendeve I dt.06.06.2016, raporti i ekspertizës së AKF-së nr.AKF/2016-1516/2016-1266 dt.25.07.2016 si dhe fotografit që gjenden në shtresa të lëndës.

#### **Përcaktimi i dënimit**

Me rastin e rritjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuadër të nenit 73, 74 dhe 75 dhe 76 të KPRK-së. Sipas nenit 74 par.3 nenpar.3.10 dhe 3.11 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurit mori pranimin e

fajësisë, dhe keqardhjen të shfaqur nga të pandehurit. I njëjti pas kryerjes së kësaj veprë penale është penduar dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale. Gjithashtu si rrethana lehtësuese gjykata mori faktin se I pandehuri për here të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe Gjykata mori parasysh edhe llojin e narkotikut që është gjetur tek I pandehuri. Këto rrethana duke i ndërlidhur me rrethanat tjera personale sjelljen korrekte gjatë procedurës.

Si rrethana rënduese gjykata vlerësoi veprimin-dashjen e të pandehurit [REDAKTUAR], pastaj shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj në kuptim të gjitha këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoj me dënim të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilat dënime janë në minimumin e paraparë ligjor, me të cilat dënime do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të nenit 41 të KPRK-së që të njëjtin ta parandalojë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Substancat narkotike të sekuestruar dhe sendet e tjera u konfiskuan në mënyrë të përhershme

Konform nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPRK-së, i akuzuari u obligua që në emër të shpenzimeve ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30/tredhjetë/ euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotefuqishmerise së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,**

**PKR.nr.133/16 dt. 06 Shtator 2016**

Bashkëpunëtare profesionale

Mirënjohje Bytyci Rexhepi

Kryetari i trupit gjyqësor

Musa Konxheli



KËSHILLA JURIDIKE, Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes kësaj gjykate.